

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	APSK: Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara u rritën me 30%, afro 2 milionë euro në 8-mujor
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/apsk-te-ardhurat-nga-qiradhenia-e-pasurive-te-sekuest ruara-dhe-konfiskua-i584972
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 13:12:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 15:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	800c467f11f901b46d7fac443033b1801e1cffe3e453ee9019a210b8f7da23a1
TEKSTI	51dee5cfa9053cb81620dee28607b7c4e10e8a9bbcf45dd5a0ed316150004f95
PAMJA	0895fb6b5d02a26370c53690adedb630cf9e2ec85c9737e3e8497412fab606a1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0fb493aeda9e0e898b37e3f65b39b6637c6a995dc7218408052475055d96c4d3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0fb493aeda9e0e898b37e3f65b39b6637c6a995dc7218408052475055d96c4d3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1e Hoxha nga Trieste: Komunikimi publik rreth zgjedhjes sonë evropiane, përparësi strategjike e politikës së jashtme"Parlamenti të luajë rol të rëndësishëm në procesin e integritetit", zbulohen kërke fundit

APSK: Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara u rritën me 30%, afro 2 milionë euro në 8-mujor

9 Shtator 2026, 17:30Kronika TEMA



 APSK: Të ardhurat nga qiradhënia e pasurive të sekuestruara dhe

Të ardhurat që shteti siguron nga dhënia me qira e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara kanë shënuar një rritje të ndjeshme gjatë vitit 2026.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), për periudhën janar-gusht 2026, të ardhurat nga qiradhënia arritën në rreth 180.3 milionë lekë, nga 139.1 milionë lekë që ishin regjistruar në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Të ardhurat janë rritur me rreth 41.2 milionë lekë, ose 29.6% krahasuar me tetëmujorin e një viti më parë.

Të dhënat mujore tregojnë se rritja është regjistruar pothuajse gjatë gjithë periudhës. Në janar 2026, AAPSK arkëtoi rreth 19 milionë lekë nga qiratë, kundrejt 14.5 milionë lekëve në janar 2025, ose rreth 30% më shumë. Në shkurt të ardhurat u rritën në 21.8 milionë lekë, nga 15.1 milionë lekë një vit më parë, duke shënuar një rritje prej rreth 44%.

Edhe në mars të ardhurat ishin ndjeshëm më të larta, me 23.9 milionë lekë, kundrejt 19.6 milionë lekëve në të njëjtin muaj të vitit të kaluar. Në prill u arkëtuan 20.3 milionë lekë, nga 18.3 milionë lekë në prill 2025.

Një nga rritjet më të forta është regjistruar në maj. Të ardhurat nga qiratë arritën në 23.7 milionë lekë, nga vetëm 14.1 milionë lekë në maj të vitit të kaluar, ose një rritje prej rreth 68%.

Tendenca pozitive vijoi edhe në qershor, kur të ardhurat arritën në 22.9 milionë lekë, kundrejt 18.2 milionë lekëve një vit më parë. Korriku ishte muaji i vetëm gjatë tetëmujorit kur të ardhurat rezultuan lehtësisht më të ulëta, me 19.8 milionë lekë, nga 20.2 milionë lekë në korrik 2025.

Ndërkohë, gushti shënoi nivelin më të lartë mujor të të ardhurave gjatë periudhës së analizuar. AAPSK arkëtoi rreth 29 milionë lekë, krahasuar me 19.1 milionë lekë në gusht 2025.

Rritja e të ardhurave nga qiratë lidhet me administrimin ekonomik të pasurive që janë sekuestruar apo konfiskuar në kuadër të procedimeve penale dhe që, në vend që të mbeten jashtë përdorimit, mund të gjenerojnë të ardhura gjatë periudhës së administrimit të tyre.

Shifrat e tetë muajve të këtij viti tregojnë se ky burim të ardhurash po merr një peshë gjithnjë e më të madhe. Me afro 180.3 milionë lekë të arkëtuara vetëm deri në fund të gushtit, AAPSK ka siguruar rreth 41 milionë lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke reflektuar një rritje të fortë të të ardhurave të gjeneruara nga pasuritë nën administrim.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-vjeçari që u gjet në bagazhin e një makine me duar të lidhura!](#)

14:50 Kronika

[Burgjet nën “përgjim”, 148 punonjës dhe 196 të izoluar të proceduar, kontrolle edhe ndaj familjarëve!](#)

12:15 Kronika / 1 koment

[Një i vdekur dhe tre të plagosur pasi ranë në kontakt me rrymën, Policia ndalon zyrtarët e Bashkisë Tropojë](#)

11:45 Kronika

[EMRI/ Shkaktoi aksidentin me vdekje në Angli, ky është shqiptari i shpallur në kërkim!](#)

11:15 Kronika / 1 koment

[Mbyllet takimi në Korçë, zbulohen 4 porositë që kryepolici Hita u la vartësve: Droga, siguria në shkolla, krimi kufitar d](#)

11:05 Kronika

[43 vatra zjarri në 24 orë në vend, 13 ende aktive - Mbrojtja: Vijon angazhimi i qindra forcave dhe mjeteve](#)

10:35 Kronika / 1 koment

[Korçë/ Zbardhen dy vjedhje, arrestohet 18-vjeçari dhe shpallet në kërkim bashkëpunëtori](#)

10:15 Kronika

[VIDEO/ Shpërthimi i pikës së karburantit, kreu i Shërbimit Zjarrfikës jep detaje: Flakët nisën nga rrjedhja e gazit, po hetohet nëse ka patur defekt teknik](#)

10:05 Kronika / 1 koment

[Shpërthimi në karburantin te "Brylli", reagon Policia: Tre punonjës të plagosur, jashtë rrezikut për jetën](#)

08:25 Kronika / 3 komente

[VIDEO/ Shpërthen denozita e karburantit pranë “Bërrylit.” shembet një godinë një katëshe](#)

07:37 Kronika / 6 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...

14:15 Politika / 53 komente

FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...

17:35 Politika / 110 komente

Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...

14:50 Politika / 10 komente

Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...

22:50 Kronika / 4 komente

Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...

19:40 Politika / 118 komente

Blog Tema

Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...

13:00 Blog / 1 koment

Një debat që nuk duhet të mbarojë te telefonat

09:45 Blog / 3 komente

25-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit: Maqedoni, mars-gusht 2001

09:15 Blog / 5 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

REGJISTROHU

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.